REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË**
**KËSHILLI**

**Nr.430. prot** **Tepelenë më , 27 .02. 2023**

**VENDIM**

**Nr.16 . datë. 23.2.2023**

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE ME FOND 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR MUAJIN JANAR 2023**

Në mbështetje te Ligjit Nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore '' neni 21 të ligjit nr 57/2019 '' Për asistencën sociale në Republikën e Shqiperisë'',VKM nr 597 datë 04.09.2019'' Për përcaktimin e procedurave , të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike '' nr. 115/2021, ''Per buxhetin e vitit 2022''.Vendimit nr. 597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave . "Për përcaktimin e kritereve të procedurave , dokumentaccionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" i ndryshuar me vendimin nr 868 date 29.12.2021;
Vendimit të Këshillit Bashkiak Tepelenë nr 4 datë 31.01.2023 ''*Për miratimin e kritereve , procedurave , dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor*'' Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga sektori i ndihmës ekonomike në mbledhjen e datës 23.2.2023

**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike 6% per muajin Janar 2023, 18 familje me fond **86921 lekë** , bashkëlidhur sipas tabelës .

| + | EMER ATËSI MBIEMËR | NR.ANTAREVE NE FAMILJE | SHUMA |
|---|---|---|---|
| | **BASHKIA E QYTETIT TEPELENË** | | |
| 1 | **BARJAM ILJAZ KOKOTI** | **2** | **5346** |
| 2 | **BUJAR VESEL METO** | **1** | **2178** |
| 3 | **ANULA KANAN MAMA** | **2** | **3703** |
| 4 | **JETNOR ZYBER CUNAJ** | **1** | **2178** |
| 5 | **ELTON BARJAM CELA** | **2** | **3267** |
| 6 | **MONIKA SAFET BETA** | **3** | **7920** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 7 | MARSELA MYZAFER ISUFI | 2 | 3703 |
| 8 | BRUNILDA MYZAFER KERI | 4 | 10692 |
| 9 | ALMIRA CETI HAZBIA | 1 | 2178 |
| 10 | ROVENA ASTRIT RACO | 4 | 10692 |
| 11 | SHPRESA SHAQO KASA | 1 | 3146 |
| 12 | BRUNILDA RIZA MAMAJ | 2 | 3703 |
| 13 | MAJLINDA EQEREM BAKO | 2 | 3703 |
| 14 | MELISA DULAJ | 2 | 5940 |
| | SHUMA | | 68349 |
| | NJESIA ADM. QENDER | | |
| 1 | HEDO GOXHA | 3 | 5227 |
| 2 | ANDON SHUMELI | 3 | 5227 |
| | SHUMA | | 10454 |
| | NJESIA ADM. KURVELESH | | |
| 1 | MARJETA VESHI | 1 | 2178 |
| | NJESIA ADM LOPES | | |
| 1 | KLODJANA ZENEL SULAJ | 2 | 5940 |
| | ------------------------------------ | | |
| | SHUMA | | 5940 |
| | | SHUMA TOTALE | 86921 |

2. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike & Menaxhimit Financiar , Drejtoria Ligjore (sektori I ndihmës ekonomike ), Njësite Administrative të Bashkisë Tepelenë për ndjekjen e këtij vendimi.
3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

KRYETAR

ELVIS SHEHU

Miratuar me 14(katërmbëdhjetë) vota
Vota Pro 14(katërmbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 27.02.2023.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË**

**KËSHILLI**

**Nr.430/2. prot** **Tepelenë më, 27.02. 2023.**

**VENDIM**

**Nr.17.datë. 23 .2 .2023**

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË BASHKISË PËR FAMILJET QË DO TE TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR MUAJIN JANAR 2022**

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 '' Për Vetëqeverisjen Vendore ' neni 21 të ligjit 57/2019, ''Për asistencën sociale në Republikën e Shqiperisë'' VKM nr 597, datë 04.09.2019, ''Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtezuar për ndihmën ekonomike'' VKB nr .95. datë 25.11.2022 '' Për miratimin e buxhetit për vitin 2023'', VKB nr. 4. datë. 31.01.2023 '' Për miratimin e kritereve procedurave , dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok ndihmës ekonomike deri ne 6% ose me fondet e buxhetit vendor'' Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 23.2.2023

**VENDOSI:**

1. Të trajtojë me ndihmë ekonomike 80 familje me fond 200.000 lekë muaji Janar 2023. Bashkëlidhur tabela.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria ekonomike & Menaxhimit Financiar Sektori i
3. Ndihmës Ekonomike dhe PAK, Drejtoria Ligjore , Njësitë Administrative të Bashkisë Tepelenë .
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**
**ELVIS SHEHU**

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA TEPELENË

Miratuar me14(katërmbëdhjetë ) vota
Vota Pro 14(katërmbëdhjetë) vota
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 27.02.2023.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KESHILLI BASHKIAK**
**TEPELENE**

**Nr.419.Prot**

**Tepelenë më , 27.02.2023**

# V E N D I M

**Nr.18.Datë. 23.2.2023**

**PËR**

## MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2022

Këshilli i Bashkisë Tepelenë në mbledhjen e datës 23.02.202, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik & Menaxhimit Financiar për zbatimin e buxhetit të Bashkisë Tepelenë për vitin 2022 , mbështetur ne :

- Ligjin 139/2015 date 17.12.2015, "Për vetqeverisjen vendore ",
- Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit e buxhetor në Republikën e Shqiperisë"; i ndryshuar
- Ligji nr 10 296 date 8.7.2010 « Për menaxhimin financiar dhe kontrollin i ndryshuar
- Ligji 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" Neni 51
- V.K.B Nr. 76 datë 25.11.2021 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2022"i ndryshuar

**<u>V E N D O S I:</u>**

1-Të miratojë Raportin Vjetor të Zbatimit të Buxhetit për vitin 2022 i cili është i krahasueshëm me planin e buxhetit vjetor 2021 dhe perfshin ;

a ) Raportin e Monitorimt të Buxhetit për vitin 2022
b) Pasqyrat Financiare të vitit 2022
c) Raportin mbi zbatimin e rekomadimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik & Menaximit Financiar

3.Ky vendim hynë në fuqi sipas përcaktimeve te nenit 55,pika 6 e ligjit nr 139/2015 « Për veteqeverisjen vendore ‘ të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër .

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

KRYETAR

ELVIS SHEHU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË

Miratuar me 14(katërmbëdhjetë) vota
Vota Pro 14(katërmbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 27.02.2023.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK**
**TEPELENE**

**Nr.430/2 Prot** **Tepelenë më, 27.2.2023**

# V E N D I M

**Nr.19.Datë. 23.2.2023**

**PËR**

**MBËSHTETJE FINANCIARE TË FAMILJEVE NË GJËNDJE TË VËSHTIRË EKONOMIKE, FATKEQESI DHE TRAJTIM SHËNDESOR**

Këshilli i Bashkisë Tepelenë në mbledhjen e datës 23.2. 2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë për mbështetje financiare të familjeve në gjendje të vështire ekeonomike,fatkeqesi dhe trajtim shëndetsor mbështetur në:

- Ligjin 139/2015 –date 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore ",
- Ligjin 57/2016, datë 02.06.2016 "Për disa shtesa e ndyshime në ligjin nr 9936 date 26.06.2008 ' Për menaxhimin e sistemit e buxhetor ne Republiken e Shqiperisë''
- Ligji 68/2017 « Për financat e vetëqevrisjes vendore «
- V.K.B Nr 95, datë 25.11.2022 .'Për miratimin e buxhetit te vitit 2023 "

**V E N D O S I:**

1. Mbështetjen Financiare për familjet në nevoje në shumën 220,000 leke sipas listës bashkanjitur këtij vendimi.

2. Mbulimin nga Buxheti i Bashkise të shpenzimeve të kryera për shërbimin e varrimit të qytetarit Mehmet Merkaj në shumen 60,000 leke

3. Dhënien e ndihmës financaire për trajtim dhe kurim të mëtejshem të qytetarit Luan Pellumb Merkohasani në shumën 150,000 leke

4. Efektet financiare të këtij vendimi mbulohen nga Buxheti i miratuar për vitin 2023

**5**-Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik & Menaxhimit Financiar për zbatimin e ketij vendimi

**6.**- Ky vendim hynë në fuqi sipas percaktimeve te nenit 55,pika 6 e ligjit nr 139/2015 « Për veteqeverisjen vendore ' të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër .

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

**KRYETAR**

**ELVIS SHEHU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA TEPELENË

Miratuar me 14(katërmbëdhjetë) vota
Vota Pro 14(katërmbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 27.02.2023.

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**
**KËSHILLI BASHKIAK**
**TEPELENË**

**Nr.430/3.Prot** **Tepelenë më , 27.02.2023**

# VENDIM

**NR.20. DATË. 23/02/ 2023**

**PËR DHËNIE TITULL NDERI**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 23/02/2023 , në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" neni 54 pika "m" ; Ligjit 112/2013 "Për dekoratat , titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit të RSH" pasi shqyrtoi materialin e Komisionit Këshillimor të Bashkisë Tepelenë

**V E N D O S I**

A. Të miratojë dhënien e titujve të nderit si më poshtë:

- Të vlerësoj me titullin: "Qytetar Nderi" **Z. *Medin Duro*** me motivacionin :***"Për kontributin e tij si drejtues dhe I zgjedhur në Kuvendin e Shqipërisë.Puna dhe aktiviteti në krye të Shoqatës "Tafil Buzi" e rendisin në radhët e intelektualëve me vlera e cilësi të rralla në mardhëniet me njerëzit , në punë,familje e shoqëri".***
- Të vlerësoj me titullin: "Qytetar Nderi" **Z. *Enver Islami*** " me motivacionin : ***"Për përkushtimin maksimal në misionin ushtarak në mbrojtje të idealeve të atdheut,intelektual dhe qytetar me virtyte të larta në Tepelenë dhe më gjerë".***

B. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsim Kulturës dhe Kujdesit Social.

C. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Sekretari i Këshillit Bashkiak** **KRYETAR**

Valbona ÇELA **ELVIS SHEHU**

REPUBLIKA E SHQIPERISË BASHKIA TEPELENË

Miratuar me 14(katërmbëdhjetë) vota
Vota Pro 14(katërmbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 27.02.2023.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I BASHKISË**
**TEPELENË**

**Nr.430/4prot.** **Tepelenë më, 27 .2. 2023**

# VENDIM

**Nr.21. Datë.23. 02.2023**
**"Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënien në përdorim të fondit kullosor ndodhur në Bashkinë Tepelenë"**

Në mbështetje të nenit 8 "Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor" dhe të nenit 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", ligjit nr.139/2015 "Per vetqeverisjen vendore"; ligjit 115/2014 "Per ndarjen administrativo territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar; ligjit nr.8743 date 22.02.2001 "Per pronat e paluajtshme te shtetit" ligjit 57/2020 "Për pyjet; ligjit nr.9693 datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor" te ndryshuar; Udhezimit nr.1 date 9.6.2016 te Ministrit te Mjedisit "Per rregullat e procedurat e kerkimit, shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor dhe kullosor publik"; mbështetur në të dhënat e certifikatave të pasurive rezulton që sipërfaqet e kërkuara bëjnë pjesë në njësitë administrative Lopës dhe Qendër, kartelave të pasurive;

## VENDOSI:

1. Te jape pelqimin ne parim per dhenien me qira per pasurite si me poshte, sipas funksionit dhe destinacionit që kanë:
2. Pasurinë me nr.789, ZK 2361, fshati Lab-Martalloz, lloji i pasurisë ``Kullotë`` në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas sipas certifikates se pronesise, kartelës së lëshuar nga ASHK dhe HTR bashkëlidhur.
3. Pasurinë me nr. 467/46, ZK 2613, fshati Matohasanaj, lloji i pasurisë ``Kullotë`` në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas sipas certifikates se pronesise, kartelës së lëshuar nga ASHK dhe HTR bashkëlidhur.
4. Pasurinë me nr.456/5, ZK 1565, fshati Dukaj, lloji i pasurisë ``Kullotë`` në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas sipas certifikates se pronesise, kartelës së lëshuar nga ASHK dhe HTR bashkëlidhur.

Të dhënat e tokave bujqësore sipas tabelës së mëposhmte:

| Nr | Njësia administrative/fshati | Zona kadastrale | Nr pasurie | Sipërfaqe $m^2$ |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Lopës/ Lab-Martalloz | 2361 | 789 | 50000 |
| 2 | Lopës/ Matohasanaj | 2613 | 467/46 | 3139 |
| 3 | Qendër/ Dukaj | 456/5 | 1565 | 16000 |

5. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit publik dhe elementeve të tij, në mbështetje të Udhëzimit nr. 1, datë 6.6.2016 te Ministrit te Mjedisit “Per rregullat e procedurat e kerkimit, shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor dhe kullosor publik” si dhe në perputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për administrimin e fondit kullosor/pyjor.
6. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e korrespodencës, plotësimin e dokumentacionit si dhe për kryerjen e procedurave të mëtejshme në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit nr. 1, datë 6.6.2016 te Ministrit te Mjedisit “Per rregullat e procedurat e kerkimit, shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor dhe kullosor publik”, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Komisioni i Qiradhënies së Pyjeve e Kullotave publike.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

**KRYETAR**

**ELVIS SHEHU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA TEPELENË

Miratuar me 14(katërmbëdhjetë) vota
Vota Pro 14(katërmbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 27.02.2023.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
TEPELENË

Nr.430/5.prot

Tepelenë më, 27 .02. 2023

**VENDIM**
**(I rishqyrtuar)**

**Nr.22.Datë.23.2.2023**

**"Për azhurnimin e hartës kadastrale për pasurite nr.206 dhe nr.189 ZK 2541 ndodhur në fshatin Luzat, Bashkia Tepelenë"**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" të ndryshuar; Ligjit nr.115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqiperisë" të ndryshuar; Ligjit nr.8743 date 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" te ndryshuar; Ligjit 8744 date 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësite e qeverisjes vendore" të ndryshuar; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara"; VKM 843 datë 6.12.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Qendër Tepelenë, të Qarkut Gjirokastër"; VKM 433/2016; mbështetur në të dhënat e Agjencise Shteterore te Kadastres (ASHK) statusi juridik i pasurive;

**VENDOSI:**

1. Azhurnimin e hartës kadastrale për pasuritë nr.206 dhe nr.189 ZK2541 fshati Luzat, të llojit "Kullote" dhe përdorimin e këtyre pasurive për rrugë publike për lidhjen e rrugës kryesore me parcelat bujqësore, kullotën dhe rrugët e tjera dytësore, sipas planvendosjes bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

**KRYETAR**

**ELVIS SHEHU**

Miratuar me 14(katërmbëdhjetë) vota

Vota Pro 14(katërmbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 27.02.2023.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I BASHKISË**
**TEPELENË**

**Nr.430/6 prot.** **Tepelenë më, 27.02 2023**

**V E N D I M**

**Nr.23. Datë.23.2.2023**

**"Për miratimin e listës me sipërfaqet e tokave bujqësore për tu dhënë me qera ndodhur në Bashkinë Tepelenë"**

Në mbështetje të nenit 8 "Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor" dhe të nenit 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", neni 3 i ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 " Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara" si dhe pika 5 dhe 11 e Udhëzimit nr.1 , datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqizimin e udhëzimit nr.3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara"; VKM Nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedures e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" te ndryshuar; Udhëzim Nr. 13, datë 26.4.2018 "Për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"; mbështetur në të dhënat e certifikatave të pasurive rezulton që sipërfaqet e kërkuara bëjnë pjesë në ZK 1913 dhe 2807 përkatësisht të njësise administrative Kurvelesh, kartelave të pasurive;

**V E N D O S I:**

1. Për miratimin e listës me sipërfaqet e tokave bujqësore për tu dhënë me qira, sipas funksionit dhe destinacionit që kanë:

- Pasuritë me nr.620/1, 621, 653, ZK 1913, fshati Gusmar, lloji i pasurisë ``Arë`` në përdorim të Bashkisë Tepelenë sipas kartelës së lëshuar nga ASHK dhe HTR bashkëlidhur.
- Pasurinë me nr.940, ZK 2807, fshati Nivice, lloji i pasurisë ``Arë`` në përdorim të Bashkisë Tepelenë sipas kartelës së lëshuar nga ASHK dhe HTR bashkëlidhur.

Të dhënat e tokave bujqësore sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr | Njësia administrative/fshati | Zona kadastrale | Nr pasurie | Sipërfaqe $m^2$ |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kurvelesh/ Gusmar | 1913 | 620/1 | 3876 |
| 2 | Kurvelesh/ Gusmar | 1913 | 621 | 1721 |
| 3 | Kurvelesh/ Gusmar | 1913 | 653 | 1725 |
| 4 | Kurvelesh/ Nivice | 2807 | 940 | 2479 |

2. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit publik dhe elementeve të tij, në mbështetje të udhëzimit nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" si dhe në perputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për administrimin e fondit tokë bujqësore, për tokat bujqësore; dhe Udhëzimit Nr. 13, datë 26.4.2018 "Për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", për pasuritë e llojit Pa Frut.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e korrespodencës, plotësimin e dokumentacionit si dhe për kryerjen e procedurave të mëtejshme në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit nr. 1, datë18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit Nr. 13, datë 26.4.2018 "Për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", për pasuritë e llojit Pa Frut, dhe ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Komisioni i Qiradhënies së Tokave bujqësore të pandara.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

**KRYETAR**

**ELVIS SHEHU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË

Miratuar me 14(katërmbëdhjetë) vota
Vota Pro 14(katërmbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 27.02.2023.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI

BASHKISË

TEPELENË

Nr.430/8.prot.

Tepelenë më, 27 .2. 2023

# VENDIM

Nr.25. Datë.23/2/2023

**Për trajtimin me bonus strehimi te disa familjeve ne nevoje te cilat nuk mund ta perballojnë qiranë në tregun e lirë**

Këshilli i Bashkisë Tepelenë në mbledhjen e tij të datës 23/ 02/ 2023 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga komisioni i strehimit të Bashkisë Tepelenë, në zbatim të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", VKM Nr 459, datë 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të Vetqeverisjes Vendore nga buxheti i shtetit për subvencinimin e qirasë ose uzurfrutit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të Vetqeverisjes Vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", VKM Nr 362, date 29.05.2019 "Për kriteret e dhenies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij" Si dhe në vijim të VKB Nr 11.datë 28.02.2022" Për trajtimin me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë te cilat nuk mund ta përballojnë qiranë në tregun e lirë"

## VENDOSI

**1.Të miratoj listën për familjet e pastreha që do të trajtohen me bonus strehimi nga buxheti i shtetit si më poshtë:**

| Nr | EMRI | MBIEMRI | VLERA QE PERFITON |
|---|---|---|---|
| 1 | Alketa | Shehu | 6000 |
| 2 | Barjam | Korkoti | 6000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 3 | Aferdita | Ramaj | 6000 | |
| 4 | Blenar | Nanaj | 7000 | |
| 5 | Blenar | Canaj | 7000 | |
| 6 | Bujar | Meta | 6000 | |
| 7 | Vjollca | Ruçi | 7000 | |
| 8 | Ermal | Çunaj | 7000 | |
| 9 | Edmir | Çunaj | 7000 | |
| 10 | Gjik | Muçi | 7000 | |
| 11 | Anulla | Mama | 6000 | |
| 12 | Fabiola | Harizi | 6000 | |
| 13 | Ilir | Dehari | 7000 | |
| 14 | Barjam | Abazi | 7000 | |
| 15 | Kanan | Hyso | 7000 | |
| 16 | KLaudeta | Halili | 7000 | |
| 17 | Petrit | Karafili | 6000 | |
| 18 | Marjola | Goxhari | 7000 | |
| 19 | Brunilda | Abazi | 7000 | |
| 20 | Entela | Saka | 6000 | |
| 21 | Vito | Beqiri | 6000 | |
| 22 | Marsela | Isufi | 7000 | |
| 23 | Pandeli | Sharkaj | 6000 | |
| 24 | Haneme | Rama | 6000 | |
| 25 | Marie | Iljazi | 7000 | |
| 26 | KLodiana | Sula | 7000 | |
| 27 | Salihe | Hysa | 7000 | |
| 28 | Agron | Rama | 7000 | |
| 29 | Majlinda | Çuni | 6000 | |
| 30 | Agim | Çela | 7000 | |
| 31 | Taulant | Qendro | 7000 | |
| 32 | Fatime | Halili | 6000 | |
| 33 | Kleopatra | Haxhia | 7000 | |
| 34 | Feride | Kasaj | 6000 | |
| 35 | Liljana | Berxhaj | 6000 | |
| 36 | Hurma | Meta | 7000 | |
| 37 | Juliana | Raça | 6000 | |
| 38 | Fatmira | Loçi | 7000 | |
| 39 | Antoneta | Dalani | 7000 | |
| 40 | Admirim | Dulaj | 6000 | |
| 41 | Simjon | Çunaj | 7000 | |
| 42 | Megli | Haxhia | 7000 | |
| 43 | Albert | Gjergo | 7000 | |
| 44 | Melisa | Dulaj | 6000 | |
| 45 | Adiona | Sharkaj | 6000 | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **46** | **Sixhei** | **Shehu** | **6000** |
| **47** | **Rexhina** | **Çuna** | **6000** |
| **48** | **Ledion** | **Beca** | **7000** |
| **49** | **Kostanova** | **Bejko** | **6000** |
| **50** | **Ema** | **Haxhia** | **7000** |
| **51** | **Edlir** | **Beca** | **7000** |
| **52** | **Vasil** | **Çunai** | **7000** |
| **53** | **Erida** | **Lepuri** | **7000** |
| **54** | **Mikel** | **Meço** | **7000** |
| **55** | **Rivelino** | **Çuni** | **7000** |

2.Efektet financiare do të përballohen do të përballohen nga fondi i miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tepelenë për vitin 2023

3.Efektet financiare fillojne 01.01.2023

4.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar.

5.Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit Qarkut Gjirokastër.

**Sekretar i Keshillit Bashkiak** **KRYETAR**

Valbona ÇELA **ELVIS SHEHU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË

Miratuar me 14(katërmbëdhjetë) vota
Vota Pro 14(katërmbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 27.02.2023.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË**
**KËSHILLI I BASHKISË**

**Nr430/9Prot.**

**Tepelenë më,27.02.2023**

# VENDIM

**Nr.26 datë. 23.2.2023**

## "PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË"

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24, të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, të nenit 38, të ligjit nr.22/2018"Për Strehimin Social", pika 4/a e VKM nr.362, datë 29.05.2019 për "Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet Buxhetit të Shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", si dhe Urdhërit Nr 38 datë 17.02.2023 për "Ngritjen e grupit të punës për miratimin e vlerës mesatare sipas strukturës së apartamenteve në treg të lirë" me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

**VENDOSI**

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë sipas strukturave të apartamentave në territorin e Bashkisë Tepelene, si më poshtë:

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Sasia | Cmimi mesatar Leke |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Banesa me qira (Apartament tip garsonierë) | Muaj | 1 | 7000 |
| 2 | Banesa me qira (Apartament 1+1) | Muaj | 1 | 8000 |
| 3 | Banesa me qira (Apartament 2+1) | Muaj | 1 | 9000 |
| 4 | Banesa me qira (Apartament 3+1) | Muaj | 1 | 11000 |

2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt-vendim.

3. Vendimi KB Nr 10 date28.02.2022 "Për vendosjen e masës se qirasë vjetore për banesat sociale me qira në Bashkinë Tepelenë" shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet zyra e strehimit.

5. Ky vendim hyn ne fuqi menjeherë.

**Sekretar i Keshillit Bashkiak** | **KRYETAR**

Valbona ÇELA | **ELVIS SHEHU**

Miratuar me 14(katërmbëdhjetë) vota
Vota Pro 14(katërmbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 27.02.2023.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA TEPELENË**
**KËSHILLI BASHKIAK TEPELENË**

Nr. 430/10 prot. Tepelenë, më 27 . 02 . 2023

**VENDIM**
**Nr. 27, datë 23 . 2 .2023**
**PËR**
**MIRATIMIN NË PARIM TË INVESTIMEVE NË PROGRAMIN E AZHBR, "IPARD III, THIRRJA E PARË"**

Bazuar në: Nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja "b" dhe pika 1/1.2, nenin 27, pika 5, nenin 36, nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", e ndryshuar; Ligjin nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", e ndryshuar; Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", e ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", e ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 06.01.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërorë që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës"; Ligji nr. 97/2022, datë 22.12.2022 "Për ratifikimin e marrëveshjes sektoriale ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Programit për Zhvillimin Rural të Instrumentit për Asistencën e Para anëtarësimit (IPARD III)"; Dokumenteve të paraqitura, si dhe Propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Tepelenë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin në parim të investimeve në programin e AZHBR, "IPARD III, Thirrja e parë".
2. Prioritet përfundimi i infrastrukturave të fshatrave të kualifikuara në "Programin e Integruar për Zhvillimin Rural – Programi i 100 Fshatrave" (Infrastruktura rrugore në fshatrat Nivicë-Rexhinë; Rruga e Fshatit Kodër; Rruga për në Kordhaj, Fshati Dukaj; Rruga e re e Fshatit Mezhgoran; Rruga për në Llufë, Fshati Rexhinë, Rruga e Fshatit Luzat, Rruga Fshati Dhëmblan, Rruga Fshati Matohasanaj etj.).

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, si dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Elvis Shehu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË

**SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Valbona Çela**

Miratuar me: 14 vota

Vota Pro: 14

Vota Kundër: -

Vota Abstenim: -

Zbardhur më datë: 27.02.2023

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA TEPELENË**
**KËSHILLI**

**Nr.430/11.Prot** **Tepelenë më , 27.02.2023**

**V E N D I M**

**Nr. 28.datë.23.02.2023**

**"PËR SISTEMIMIN NË QENDRËN PËR TË PASTREHËT DHE TË FAMILJEVE NË NEVOJË TË BASHKISË TEPELENE"**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", ligjit 22/2018 "Për strehimin social" kreu X , neni 58 e në vazhdim , VKM nr. 459 datë 03.07.2019 "Për rregullat për Administrimin e kërkesave të Vetëqeverisjes Vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvensionimin e qirasë ose uzurfrutit, mënyrën e financimit të subvensionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për strehimin" , VKM nr. 454, datë 3.7.2019, VKM nr. 458, datë 3.7.2019, VKM nr.823, datë 18.12.2019 dhe Udhëzimittë Ministrit nr. 31, datë 18.11.2019,VKM nr.362 date 29.05.2019 "Për kriteret e subvensionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvensionimin që qëzojnë përparësi në subvensionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", Ligjit 121/2016 date 24.11.2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë" , Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr 38 datë 15.11.2012 "Për vendosjen e masës së qerasë vjetore për banesat sociale dhe dhënien me qira në Bashkinë Tepelenë" , Vendim të Këshillit të Bashkisë Nr 26 datë 29.03.2019 "Për miratim të listës së inventarizimit të pronave të Paluajtshme shtetërore të Bashkisë Tepelenë" , VKB nr 92 date 25.11.2022 "Për miratim të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë" pika 10, Këshilli Bashkiak pasi shqyrtoi materialin e Drejtorisë së Arsim Sporteve dhe Kujdesit Social si dhe Sektorit të Strehimit në Bashkinë Tepelenë

**V E N D O S I**

1- Të miratojë sistemimin e të moshuarit Selam Qendro në Qendrën për të pastrehët dhe të familjeve në nevojë të Bashkisë Tepelenë .
   - Periudha e strehimit në qendër do të jetë 1-vjeçare nga data e miratimit të këtij Vendimi.
   - Pagesa e qerasë në banesë do të jetë zero lekë.

- Gjatë periudhës së strehimit të zbatohet rregullorja e brendshme e funksionimit të Qendrës.

2- Të miratojë sistemimin e familjes Jorgo Lengu në Qendrën për të pastrehët dhe të familjeve në nevojë të Bashkisë Tepelenë .

- Periudha e strehimit në qendër do të jetë 1-vjeçare nga data e miratimit të këtij Vendimi.
- Pagesa e qerasë në banesë do të jetë VKB nr 92 date 25.11.2022 "Për miratim të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë" pika 10.
- Gjatë periudhës së strehimit të zbatohet rregullorja e brendshme e funksionimit të Qendrës.

3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsim Kulturës dhe Kujdesit Social.

4- Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6 të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore"

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

**KRYETAR**

**ELVIS SHEHU**

Miratuar me 14(katërmbëdhjetë) vota
Vota Pro 14(katërmbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 27.02.2023.